



PROJECT IMPLEMENTED BY JV NTU/EPTISA



WORLD BANK GROUP

FINANCED BY GOA AND COFINANCED BY WB

## **AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR**

### **Projekti i Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)**

Hua e Bankës Botërore Nr. 8489-AL

Nr. i Kontratës: CS 02

## **Shërbime Konsulence**

**për**


## **Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore**

# **Seminar mbi Zhvillimin e Kapaciteteve lidhur me Sistemet e Monitorimit dhe Vlerësimit**

**D-1.6 Shtojca 4**

**Versioni Paraprak**

**Prill 2021**



## TË DHËNAT IDENTIFIKUESE TË PROJEKTIT

<b>Emri i projektit:</b>	Shërbime Konsulence për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore për Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP) për Rrjetin Rrugor Kombëtar
<b>Numri referues i Kontratës së Projektit:</b>	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL
<b>Vendi:</b>	Shqipëri
<b>Konsulenti:</b>	JV NTU InternationalA/S / EPTISA Servicios De Ingenieria S.L.
<b>Adresa:</b>	Vestre Havnepromenade 5, 4. Floor DK-9000 Aalborg Denmark
<b>Telefon:</b>	+45 99 30 0000
<b>Fax:</b>	+45 99 30 0001
<b>Person Kontakti:</b>	Dritan Dibra – Menaxher Projekti, Eptisa
<b>E-mail:</b>	<a href="mailto:ddibra@eptisa.com">ddibra@eptisa.com</a>
<b>Data e Raportit:</b>	Prill 2021
<b>Autorët e raportit:</b>	Desmond Myers, K-4 Specialist i Menaxhimit të Zbatimit  <i>Me të dhëna:</i> <i>Stelios Efstathiadis, K-1 Specialist për Menaxhimin e Sigurisë Rrugore - Lider Grupi</i> <i>Edoardo Mazzia, K-5 Specialist për Sigurinë Rrugore</i>

## SQARIM

*Ky raport (përfshirë shtojcat dhe materialet bashkëlidhëse) është përgatitur ekskluzivisht për përdorim nga Qeveria Shqiptare/ Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Banka Botërore, dhe vetëm për qëllimin për të cilin është hartuar. Përveç rasteve kur BO NTU/EPTISA jep miratimin e saj me shkrim, asnjë pjesë e këtij raporti nuk mund të kopjohet, riprodhohet apo të përdoret nga palë të treta. BO NTU/EPTISA nuk mban asnjë përgjegjësi nëse ky raport përdoret për qëllime të tjera nga i cili është menduar, apo përdoret nga palë të treta.*

## DOKUMENTI KONTROLLUES

<b>Numri i referencës së Kontratës së Projektit:</b>	WB2400-05/17, IBRD 84890TF 14761, P132982, CS 2, 8489 – AL Shërbim Konsulence për Asistencë Teknike për Sigurinë Rrugore për Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore Bazuar në Rezultate (RRMSP)
<b>Shteti</b>	Shqipëri
<b>Date</b>	30.04.2021
<b>Versioni</b>	N°01

Versioni	Datë	Përgatiti	Rishikuar
N°01	11.01.2021	Desmond Myers	Dragan Kostadinov Drejtör Projekti

## PERMBLEDHJE

Ky Raport mbi Seminarin e Zhvillimit të Kapaciteteve për Monitorimin dhe Vlerësimin përbën Raportin 1.7.2 të Komponentit 1 për Asistencën Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) nën Projektin e Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore bazuar në rezultate (RRMSP). Kjo është përmbledhëse e detyrës së mëposhtme:

- Detyra 1.7.2 Trajnimi i stafit të agjensisë kryesore të sigurisë rrugore lidhur me monitorimin dhe vlerësimin duke përfshirë ARRSH-në, Policinë, stafin e konsulentëve lokale si dhe përfaqësues të kompanive private.

Aktivitetet e Komponentit 1 synojnë të:

- Mbështesin Zyrën Qendrore (Departamenti i Sigurisë Rrugore - MoTI) duke zhvilluar kapacitete dhe procedurë të brendshme për të kryer funksione institucionale të bazuara në rezultate: ... "Monitorimi dhe Vlerësimi" për të qenë në gjendje të monitorojë rezultatet dhe të vlerësojë efektivitetin e ndërhyrjeve si dhe përgatitja e programeve përfshirë menaxhimin dhe koordinimin siç kërkohet, për të deleguar një pjesë të këtij funksioni tek organizatat e palët të treta (p.sh. Instituti i Trafikut ose sektori privat).
- Mbështesin Zyrën Qendrore si teknikisht ashtu edhe administrativisht në detyrat multidisiplinore në të gjithë aspektet e sigurisë rrugore siç është ai i rrugëve, automjeteve dhe përdoruesve të rrugës.
- Sigurojnë mbështetje të trajnimit në praktikë të nevojshëm për të krijuar një Zyrë të Fortë Qendrore.

Rezultatet kryesore duhet të arrihen përmes zbatimit të aktiviteteve dhe detyrave të Komponentit 1 janë si më poshtë:

- a) Zhvillimi i kapaciteteve dhe procedurave të brendshme të Zyrës Qendrore për të kryer funksione institucionale sipas rezultateve.
- b) Mbështetja për Zyrën Qendrore si teknikisht ashtu edhe nga ana administrative që kanë të bëjnë me rrugët, automjetet dhe përdoruesit e rrugës.
- c) Trajnimi në praktikë dhe mbështetje në punë dhe mësim për krijimin e një Zyre Qendrore të Fuqishme.

Ky raport përshkruan seminarin online lidhur me Zhvillimin e Kapaciteteve për Monitorimin dhe Vlerësimin. Objektivi ishte ndërtimi i njohurive, aftësive dhe udhëheqjes profesionale të nevojshme për të filluar dhe menaxhuar në mënyrë efektive monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve të sigurisë rrugore, të cilat janë thelbësore për një qasje të bazuar në rezultate të menaxhimit të sigurisë rrugore.

## PËRMBAJTJA

<b>1. Përshkrimi i Projektit .....</b>	<b>9</b>
1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Seminarit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
1.2 Rezultatet e Seminarit .....	10
1.3 Pjesëmarrësit në Seminar .....	11
1.4 Datat dhe Rezultati i Seminarit.....	11
1.5 Ekipi i Trajnues i Seminarit.....	11
<b>2. Përmbajtja e Seminarit .....</b>	<b>12</b>
2.1 Përmbajtje Interaktive .....	12
<b>3. Vlerësimi i Seminarit lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin.....</b>	<b>20</b>
3.1 Dita 1: Seminari Moduli 1 dhe 2 .....	20
3.2 Dita 2: Seminari Moduli 3 .....	20
3.3 Dita 3: Seminari Moduli 4 .....	20
3.4 Përfundimi i Seminarit .....	20
3.5 Vlerësimi Seminarit.....	21
<b>ANEKSI A FORMULARI I VLERËSIMIT ONLINE .....</b>	<b>24</b>

## LISTA E FIGURAVE

Tabela 1: Komponenti 1 – Detyrat dhe Dokumentet .....	9
Figura 1 – Programi Seminarit .....	12
Figura 2 – M&E Pyetje .....	13
Figura 3 – Ushtrimi 1 Përlogaritja Social –Ekonomike e Kostos Traumës nga aksidentet rrugore .....	14
Figura 4 – Ushtrimi 2 Interpretimi i të dhënave .....	15
Figura 5 – Ushtrimi 3 Vlerësimi i ndërhyrjeve Inxhinerike .....	16
Figura 6 – Ushtrimi 4 Vlerësimi i Trajtimeve Inxhinerike .....	17
Figura 7 – Përmbajtja e Seminarit .....	19
Figura 8 – Përmbledhja e Seminarit .....	21
Figura 9 – Rëndësia e Seminarit M&E .....	22
.....	22
Figura 10 –Vlerësimi me pikë i seminarit .....	23

## LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AADT	Trafiku Ditor Mesatar Vjetor
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
ANPR	Njohja Automatike e Targave
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
KRRSH	Kodi Rrugor Shqiptar
RRTPRR	Rregulli Teknik Të Projektimit të Rrugëve
RRTNRR	Rregulli Teknik Të Ndërtimit të Rrugëve
MPRR	Manuali i Projektimit të Rrugëve
ASP	Policia e Shtetit
MAT	Matës Automati i Trafikut
PRR	Policia Rrugore
PZ	Pikat e zeza
TKMIE	Trupi kontrollues në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
GDQ	Grupi Drejtues Qendror
DRST	Drejtoria e Trafikut Sigurisë Rrugore
KE	Komisioni Evropian
GE	Grupi i Ekspertëve në Nivel Lokal
BE	Bashkimi Evropian
GoA	Qeveria Shqiptare
GRD	Drejtori i Përgjithshëm i Rrugëve
KNSRR	Komiteti Ndërmisor i Sigurisë Rrugore
INSTAT	Instituti i Statistikave
IoT	Instituti i Transportit
IPA	Instrumenti për asistencë për para-antarësimin
Irap	Programi Ndërkombëtar i vlerësimit të Rrugëve
ITS	Sistemi Inteligjent i Trafikut
BO	Bashkim Operatorësh
M&E	Monitorim dhe Vlerësim
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MB	Ministria e Brendshme
OJQ	Organizatë jo qeveritare
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MRRRR	Menaxhimi i Rrjetit Rrugor
MAPBESH	Misioni i Asistencës Policore të Bashkisë Evropiane në Shqipëri
RRMSP	Projekti për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë në Rrugë të Bazuar në Rezultate
ASR	Auditi i Sigurisë Rrugore
ASRNJI	Auditi i Sigurisë Rrugore dhe Njësia e Inspektimit
RSS	Spektori i Sigurisë Rrugore
RSI	Inspektim i sigurisë rrugore
VNSRR	Vlerësim i Ndikimit të Sigurisë Rrugore
SEETO	Vëzhgimi i Transport për Europën Juglindore
TA	Asistencë Teknike
RRTE	Rrjeti Rrugor Trans Evropian
ToR	Terma Reference

ST	Sekretariati Teknik
BB	Banka Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

## 1. Hyrje e Projektit

Ky Raport mbi Seminarin e Zhvillimit të Kapaciteteve për Monitorimin dhe Vlerësimin përbën Raportin 1.7.2 të Komponentit 1 për Asistencën Teknike të Sigurisë Rrugore (AT) në bazë të Projektit të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore të Bazuar në Rezultate (RRMSP). Raporti siguron një përmbledhje të zhvillimit të objektivave, përmbytjes dhe vlerësimit të seminarit.

Projekti i Asistencës Teknike të Sigurisë Rrugore përbëhet nga katër produkte kryesore nën RRMSP, të cilat përfshijnë: (1) Fuqizimi i departamentit të sigurisë rrugore të MIIIE si zyra kryesore; (2) Sigurimi i ndihmës teknike në infrastrukturën e sigurt rrugore; (3) Vendosja e Sistemeve të Monitorimit dhe Vlerësimit të Qëndrueshëm; dhe (4) Percaktimi dhe evidentimi i sjelljeve në kundëstetim me ligjin në rrugët shqiptare

Brenda Komponentit 1 të Projektit, Aktiviteti 7 përqendrohet në mbështetjen e Zyrës Qendrore (Departamenti i Sigurisë Rrugore - MoTI) duke zhvilluar kapacitete dhe procedura të brendshme për të kryer funksione institucionale "Bazuar në Rezultate": ... ". Përmban katër Detyra kryesore, me nga shtatë nën detyra dhe 10 rezultate siç detajohen në Tabelën 1.

Tabela 1: Komponenti 1–Detyrat dhe Dokumentet

	Nën pika nr.	Dokumentet
<b>Pika 1.7.1:</b> Hartimi dhe mbështetja e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të projektit për korridoret dhe zonat me rrezik të lartë (dhe kontrollin e korridoreve dhe zonave).	1.7.1a	Dokumenti specifik i masave tipike (karakteristike) të performancës së sigurisë rrugore në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë
	1.7.1b	Raporti bazë i Rezultateve të Studimit lidhur me korridoret dhe zonat me rrezik të lartë
	1.7.1c	Specifikimi dhe kostoja e pajisjeve të vrojtimit, sistemi i përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave, dhe kërkesat për personelin (specifikimet teknike për prokurimin e pajisjeve të vrojtimit, nëse kërkohet).
	1.7.1d	Udhëzime për kryerjen e vrojtimit dhe përpunimin e të dhënave për raportimin tremujor dhe vjetor.
	1.7.1e	Lista e furnitorëve të shërbimeve të vrojtimit të të dhënave
	1.7.1f	Raporti i Zhvillimit të Kapaciteteve në praktike lidhur me vrojtimit e vazhdueshme .
	1.7.1g	Raporti i Rishikimit të Treguesve të Rezultateve të Projektit
<b>Pika 1.7.2:</b> <i>Trajnimi i stafit të agjencisë për monitorimin dhe vlerësimin përfshirë ARRSH-në, dhe Policinë dhe stafin kombëtar të konsulencës dhe të institucioneve private.</i>		<b>Raporti i Seminarit për Zhvillimin e Kapaciteteve lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin</b>
<b>Pika 1.7.3:</b> Vlerësoni efikasitetin dhe efektivitetin e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit në korridoret dhe zonat me rrezik të lartë (dhe korridoret dhe zonat e kontrollit).		Raporti i Rishikimit të Sistemit të Monitorimit dhe Vlerësimit
<b>Pika 1.7.4:</b> Përgatitja e programit (kombëtar) pas-projektit dhe udhëzimet për krijimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi në të gjithë rrjetin.		Programi i monitorimit post – projekti dhe vlerësimit në mbarë rrjetin , përfshirë udhëzimet e rishikuara.

### 1.1 Objektivat dhe Qëllimet e Trajnimit/Seminarit

Seminari lidhur me rritjen e kapaciteteve të Monitorimit dhe Vlerësimit ('Workshop M&E') u realizua për të siguruar drejtuesit e nivelit të mesëm dhe të lartë në agjensitë kryesore të sigurisë rrugore (si qeveria dhe shoqëria civile) me njohuri për rolin e monitorimit dhe vlerësimit në kuadrin e Sistemit të Sigurtë dhe Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Rrugore, bazuar në rezultate. Seminari ka dhënë parimet dhe konceptet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit si dhe principet bazë në praktikë për një monitorim dhe vlerësim efektiv.

Qëllimi i seminarit ishte:

- T'ju sigurojë pjesëmarrësve që menaxhojnë projekte dhe programe të sigurisë rrugore, veçanërisht ata që punojnë brenda agjensive qeveritare, me një kuptim praktik të monitorimit dhe vlerësimit të sigurisë rrugore.
- T'ju sigurojë pjesëmarrësve njohuri, aftësi dhe mjete themelore për të zbatimin e projektit si dhe monitorimin e vazhdueshëm si dhe për të menaxhuar dhe / ose koordinuar në mënyrë efektive vlerësimet lidhur me projektin nga vlerësues të pavarur.
- T'ju japë njohuri pjesëmarrësve lidhur me kuptimin e rezultateve të vlerësimit.

Objektivat specifike janë si më poshtë:

- Kuptimi i termave dhe koncepteve të monitorimit dhe vlerësimit të sigurisë rrugore - në mënyrë që Udhëzuesit të përdoren në mënyrë efektive.
- Të kuptojë kontekstin aktual strategjik për monitorimin dhe vlerësimin - për të rritur angazhimin për monitorimin për vitin 2030 lidhur me sjelljen e përdoruesve të rrugës si dhe e çështjeve të caktuara.
- Kuptimi i rëndësisë të të dhënave dhe informacionit.
- Identifikimi i Indikatorëve të performancës lidhur me ndërhyrjet në drejtim të sigurisë rrugore.
- Identifikimi i të dhënave kryesore të kërkuara për monitorimin dhe vlerësimin e sigurisë rrugore.
- Të kuptojë metodat themelore të monitorimit dhe vlerësimit - për të rritur aftësitë për të menaxhuar konsulentët e jashtëm që mund të merren me procesin e vlerësimit.
- Shpërndarja e informacionit lidhur me eksperiencën ndërkombëtare të programeve që kanë të bëjnë me masat inxhinierike të uljes shpejtesise.

Përmbajtja e seminarit ka pasur seanca teorike të prezantuara përmes prezantimeve në PowerPoint, një kuiz, shembuj të praktikave më të mira dhe raste studimore si dhe ushtrime të pjesëmarrësve.

### 1.2 Rezultatet e Seminarit

Njohuritë e marra gjatë seminarit lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin do të ndihmojë menaxherët të përdorin udhëzuesit e monitorimit të përgatitura gjatë projektit për të arritur rezultatet e mëposhtme:

- a) Zhvillimi i kapaciteteve dhe procedurave të brendshme të Njesisë Drejtuese për të realizuar funksionet institucionale*
- b) Njësia Drejtuese është e mbështetur si nga pikëpamje teknike dhe administrative lidhur me detyrat që ajo duhet të kryejë lidhur me rrugët, mjetet si dhe përdoruesit e rrugës.*
- c) Krijimi i Një Njësie Drejtuese*

### 1.3 Pjesëmarrësit në Seminar

Programi i seminarit është strukturuar në përputhje me Kontratën dhe i është vënë në dispozicion Klientit në Raportet e kaluara. Programi i Seminarit u modifikua në mënyrë që të përmbushte kufizimet e pandemisë dhe për këtë Klienti u informua në datën 2 Mars. Një kërkesë zyrtare u paraqit në 8 Mars dhe Komiteti Drejtues ra dakord mbi Planin e Përditësuar të Punës në 12 Mars 2021. Përmbajtja përfundimtare u paraqit për përkthim.

Një ftesë për Seminarin si dhe informacioni lidhur me adresën në internet të seminarit u dërguan me email një liste të gjerë të pjesëmarrësish. Persona të tjerë mund të marrin pjesë në seminar.

### 1.4 Datat dhe Rezultati i Seminarit

Seminari u konceptua të realizohej nëpërmjet kombinimit të mësimin në distancë në mënyrë të sinkronizuar dhe të pa-sinkronizuar.

#### Sesionet e sinkronizuara

Tre seanca të seminarit u kryen nëpërmjet Zoom-it në datat e mëposhtme ku të gjithë pjesëmarrësit morën pjesë.

- 9 Mars: 3-orë
- 10 Mars: 3-orë
- 24 Mars 2.5-orë

Si pjesë e prezantimit të Seminarit në Ditën 1 dhe brenda sesionit të Mirëseardhjes në Ditët 2 dhe 3 pjesëmarrësit u ftuan të paraqisnin pyetje dhe komente për trajnuesit.

#### Seancat e trajnimit të pa-sinkronizuar

Të gjitha seancat e Seminarit u regjistruan, video dhe materiali i seances së trajnimit janë ngarkuar në faqen e internetit të projektit ([siguriarrugore.al](http://siguriarrugore.al)) për të ndihmuar individë për të pasur akses në materialin e seminarit kur ata të dëshirojnë, ose si pjesë e kërkesave të vazhdueshme të trajnimit profesional.

### 1.5 Grupi i Trajnimit

Fillimisht Seminari u përgatit të kryhej nga Znj. Rosemary Rouse, Specialiste e Monitorimit dhe Vlerësimit. Sidoqoftë, për të shmangur përkthimin e panevojshëm të ushtrimeve të seminarit në Ditën 2, Z. Edmond Alite u informua plotësisht për metodologjinë dhe përmbajtjen për secilin ushtrim dhe ra dakord për t'i kthyer në shqip.

Trajnimi u dha në anglisht në Ditën 1 dhe Ditën 3 me përkthim simultan në shqip. Dita 2 u mbajt në shqip.

## 2. Përmbajtja e Seminarit

Fillimisht, ishte planifikuar një Kurs Trajnimi shumë-pjesëmarrës dy-ditësh me prezencë të pjesëmarrësve, i cili përfshinte një seri diskutimesh / pikash reflektimi dhe ushtrimesh që duheshin ndërmarrë individualisht / në grupe të ndjekura nga diskutime të të tëra grupeve për t'u ofruar të gjithë pjesëmarrësve mundësi për të marrë informacion, fituar aftësi dhe konsolidim të njohurive. Për më tepër, ishte parashikuar përgatitje e një liste me terminologjinë kryesore të Monitorimit dhe Vlerësimit si dhe ushtrime praktike për secilën fushë.

Për shkak të kufizimeve të vazhdueshme të shkaktuara nga pandemia Covid-19, i gjithë trajnimi u kërkua të ofrohej në distancë duke përdorur teknologjinë për të lidhur pjesëmarrësit me përmbajtjen. Meqenëse komunikimi në distancë u krye nëpërmjet përkthimit simultan, seminari u përgatit dhe u mbajt në bazë të komunikimit në distancë.

- Janë zhvilluar dy seanca me nga 3 orë dhe një séance 2 orë, në një seri prej 3 ditësh.
- Ushtrimet u krijuan për t'u dhënë si shembuj të cilët do të zgjidheshin gjatë seancave të seminarit. Në pikat kyçe u zhvilluan ushtrime për të rishikuar përmbajtjen kryesore dhe lektori i drejtoi pjesëmarrësit përmes metodologjisë dhe procesit të M&E dhe gjithashtu dha përgjigjet e duhura.

Overview of the Online Workshop

WORKSHOP SESSION	DATE AND TIME	DURATION	CONTENT
DAY ONE	9/3/2021	1.5 hours	Module 1
	9/3/2021	1.5 hour	Module 2
DAY TWO	10/3/2021	3 hours	Module 3
DAY THREE	24/3/2021	2 hours	Module 4 & evaluation

Workshop Participant Workbook

Road Safety Monitoring & Evaluation Online Workshop Participant Workbook

Figura1 – Programi Seminarit

Përmbajtja e seminarit u përqëndrua në dymbëdhjetë objektivat globale të performancës së sigurisë rrugore të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara (KB) për vitin 2030, treguesit e performancës së sigurisë rrugore të Bashkimit Evropian (BE) dhe Indikatorët e Performancës të përdorura në Australi, Programi Evropian i Vlerësimit të Makinave të Reja (EuroNCAP) dhe programi ndërkombëtar i vlerësimit të sigurisë rrugore (iRAP) për Indikatorët e monitorimit të standardeve të sigurisë rrugore dhe mjeteve. Në seminar u dhanë shembuj të ndërhyrjeve inxhinierike, teknike dhe arsimore / ndërgjegjësuere për të dhënë rëndësinë e një game të gjerë të disiplinave të sigurisë rrugore.


### 2.1 Përmbajtje Interaktive

Seminari online e bëri të vështirë punën në grupe të vogla / diskutimin e tërë grupit. Sidoqoftë, përmbajtja u bë sa më tërheqëse që të ishte e mundur përmes përfshirjes së kuiceve, dhe ushtrimeve për ti mbajtur aktiv pjesëmarrësit.

## M&E Pyetje

Pyetjet M&E janë bërë për të mbajtur aktive pjesëmarrësit në seminar dhe për të nxitur mendimin kritik. Gjatë seminarit u paraqitën një sërë pyetjesh për të klasifikuar nëse aktivitetet ishin monitorim apo vlerësim. Përgjigjet u dhanë pasi pjesëmarrësit dhanë vlerësimin e tyre.

Figura 2 – M&E Pyetje



**Quick Quiz: Monitoring or Evaluation?**

1. your credit card balance
2. Uber driver rating
3. temperature, humidity, biometric pressure
4. when to apply sunscreen
5. speed of service, quality of food
6. credit rating
7. purchase new printer ink cartridge
8. ink levels in printer
9. speedometer reading, road conditions, speed limit
10. Uber ride service quality
11. Do I leave a tip?
12. UV levels
13. Do I accelerate, slow down, or do neither
14. weather forecast
15. ink levels in printer

**We all monitor and evaluate daily**

Consultant Service **ep/sa**

## Ushtrime

Fillimisht ishte planifikuar t'u sigurohej pjesëmarrësve një faqe pune paraprakisht dhe të sigurohej mbështetje online para-Seminarit për të përfunduar ushtrimet të cilat mund të rishikoheshin shkurtimisht gjatë Seminarit. Sidoqoftë pasi shumë pjesëmarrës morën pjesë njëkohësisht në disa seminare, kjo nuk ishte e mundur. Duke pasur parasysh nevojën për të angazhuar plotësisht pjesëmarrësit dhe kohëzgjatjen e secilit sesion, nuk ishte gjithashtu e mundur që pjesëmarrësit të bënin 'pushim' për të ndërmarrë ushtrime gjatë seminarit.

Ushtrimet përfundimtare u hartuan si shembuj të punuar të prezantuar nga Traineri gjatë seminarit. Qëllimi i ushtrimeve ishte konsolidimi i koncepteve kryesore dhe ofrimi i mundësive për të rritur të kuptuarit e teorisë, aftësive në analizën e të dhënave dhe të kuptuarit në punë të metodologjive M&E. Çdo ushtrim u prezantua si 'copa' të vogla informacioni, pasuar nga diskutimi i koncepteve përkatëse, metodologjive të përdorura dhe përgjigjeve. Çështjet praktike për menaxherët në agjencitë qeveritare gjithashtu u ngritën dhe diskutuan.

- Ushtrimi 1: Llogaritja e Kostos Socio-Ekonomike të Traumës Rrugore - duke përdorur të dhënat e vlerësimit të kostove të Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare gjithashtu u ngritën dhe diskutuan.

Gjatë seminarit u prezantuan dy shembuj të llogaritjes së koston socio-ekonomike të traumës rrugore duke përdorur të dhëna të siguruar nga të Banka Botërore dhe të dhënat e Qeverisë Shqiptare. Specialisti i Analizës së Sigurisë NK-1 realizoi ushtrimin duke përdorur të dhëna Qeverisë Shqiptare me qëllim që ushtrimi të ishte i dobishëm për pjesëmarrësit.

*Figura 3 –Ushtrimi 1 Për llogaritja Social –Ekonomike e Koston Traumës nga aksidentet rrugore*

Data Field – Albanian Data	Central Values
	Set out the calculation
Total Serious Injury Cost in 2016	42,512,760
Total Serious Injury Cost in 2017	35,084,880
Total Serious Injury Cost in 2018	34,768,800
Total Serious Injury Cost Cost for 2016-2018	137,515,872
Three-year average cost of a Fatality for 2016-2018	37,455,480
Three-year average cost of a Serious Injury (2016-2018)	45,838,624

Consultant Service for Road Safety Technical Assistance

5

Te Dhena Banka Boterore	Vlerat
2018 GDP /Banore (Banka Boterore)	USD \$5,268.85
Kosto e aksidentit me vdekje	70 x GDP/Banore \$5,268.85
Aksidente me vdekje per vitet 2016, 2017, 2018	269 ne 2016 222 ne 2017 220 ne 2018
Kosto e aksidentit me vdekje 2016	(70 x \$5,268.85) x no. i aksidenteve= \$
Kosto e aksidentit me vdekje 2017	= \$
Kosto e aksidentit me vdekje 2018	= \$
Kosto e aksidentit te rende (25% e kostove te aksidentit me vdekje)	17.5 x \$5,268.85 = \$
Numri i aksidenteve te renda	15* numri i aksidenteve me vdekje/vit
Aksidente te renda 2016, 2017 dhe 2018	Aksidentete rendax15

Consultant Service for Road Safety Technical Assistance

2

- Ushtrimi 2: Interpretimi i Raportit të Sigurisë Rrugore

U prezantua një raport i përkohshëm vjetor mbi fatalitetet e sigurisë rrugore dhe dëmtimet serioze i përgatitur në NSW Australi, i cili përfshinte 15 pyetje mbi të dhënat e raportit. Ushtrimi synonte të rishikonte termat kryesorë të sigurisë rrugore, SPI-të dhe aftësitë lidhur me interpretimin dhe përdorimin e të dhënave për të udhëhequr politikën, strategjinë dhe shpërndarjen e programit.

## Workbook Exercise 2: Interpreting Final Outcome Data



### Discussion of Methodology and Answers

## Exercise 2: NSW Road Toll Progress Report

- What road user groups had a **decrease** in fatalities in 2017?  
Motorcyclists, Light trucks and Heavy trucks had a decrease in fatalities.
- What road user groups had an **increase** in fatalities in 2017 compared to 2016?  
Passenger cars and Bicyclists had an increase in fatalities.
- Name 3 road user groups that recorded the highest number of fatalities in 2017?  
Passenger cars, Heavy trucks and Light trucks.
- What was the fatality rate/100,000 population in 2016 and 2017?  
The fatality rate in 2016 was 4.99 and in 2017 it was 4.91.

Figura 4 – Ushtrimi 2 Interpretimi i të dhënave

- Ushtrimi 3 : Identifikimi i indikatorëve të performancës dhe objektivat e ndërmjetëm Shqipëria 2030.


Ky ushtrim ndoqi një modul mbi procesin dhe kërkesat kryesore për vendosjen e Indikatorëve të Performancës, ndikimin dhe nivelin e rezultatit ,prezantimin dhe diskutimin e një sërë Indikatorëve ekzistues të përdorur nga KE, KB, iRAP, EuroNCAP dhe Australia. Pjesëmarrësve në fund të seancës iu kërkuar të marrin në konsideratë dhe të identifikojnë Indikatorët e përshtatshëm për monitorimin e rezultateve të ndërmjetme deri në vitin 2030.

- Ushtrimi 4: Vlerësimi i trajtimeve që kanë synim parandalimin e aksidenteve kur mjeti del jashtë rruge.

Ky ushtrim u përgatit për të rishikuar konceptet kryesore të vlerësimit. Ushtrimi përfshiu nëntë pyetje për të rishikuar qëllimin e vlerësimit, hartimin e kërimit, fazën e vlerësimit, terminologjinë lidhur me kontrollin, kampionin eurvejimeve , të dhënave lidhur me indikatorët si dhe identifikimin dhe deklarimin e gjetjeve të vlerësimit.

Figura 5 – Ushtrimi 3 Vlerësimi i ndërhyrjeve Inxhinierike

#### Study of Relative Effectiveness of Run-off-Road Crash Prevention Treatments



#### Workbook Exercise 4: Discussion & Answers

1. The research design used is a
  2. What program stage being evaluated is
  3. The Evaluation Aim was to
  4. The type of intervention evaluated was
  5. The Case Intervention was a
1. Time Series / Case and Control Research design
  2. Final Outcome Stage
  3. Determine the effectiveness of the crash prevention treatments
  4. A road engineering prevention treatment for run-off-road crashes
  5. The Case Intervention consisted of run-off-road crash treatments on country highways with a 100km/h speed limit

- Vlerësimi i Programit 40 km/orë shpejtësi maksimale

U prezantua një rast studimi i zbatimit dhe vlerësimit të programit pilot të kufirit të shpejtësisë urbane 40 km / h në NSW Australi. Studimi paraqitur nga Traineri ishte një shembull real për të rishikuar përmbajtjen kryesore të paraqitur në modulën e vlerësimit dhe për të identifikuar sfidat praktike siç janë alokimi i burimeve për vlerësim, rëndësia e mbledhjes së të dhënave bazë dhe monitorimi i të dhënave, nevoja për të kapur mundësitë për të zbatuar vlerësimet, përzgjedhja e një metodologjie dhe SPI, procesin e zbatimit dhe përfitimet e rëndësishme të vlerësimit në nivele provinciale / kombëtare.



Figura 6 – Ushtrimi 4 Vlerësimi i Trajtimeve Inxhinierike

Programi i Seminarit u krijua për t'u ofruar nga Specialisti i Monitorimit dhe Vlerësimit me përkthim simultan në shqip. Shkurtime ishin planifikuar për të siguruar që vëmendja e pjesëmarrësve të mbahej gjatë gjithë seancës.

### **Dita 1: Monitorimi i Sigurisë Rrugore**

#### **Moduli 1: Monitorimi & Vlerësimi i Sigurisë rrugore**

Qëllimet e seminarit dhe objektivat e trajnimit. Deklarata e njohurive dhe aftësive të fituara nga seminari dhe rezultatet kryesore të trainimit:

- Shpjegoni përfitimet praktike të monitorimit dhe vlerësimit.
- Identifikoni Indikatorët e duhur të Performancës së Sigurisë (SPI) dhe të dhënat e kërkuara për monitorimin e performancës.
- Përkthuni rolin që luan monitorimi dhe vlerësimi në Qasjen e Sistemit të Sigurt dhe në Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Rrugore
- Përkthuni metodologjitë e zakonshme të hulumtimit për vlerësimin e ndërhyrjeve.
- Identifikoni mjetet e përshtatshme për të kryer vlerësime.
- Zbatoni një proces për të planifikuar dhe kryer monitorimin dhe vlerësimin.

Përkufizimi i terminologjisë kryesore, përmban proceset kryesore të monitorimit dhe elementet si dhe rëndësia e saj në sigurimin e përqendrimit në rezultate dhe përdorimin efektiv të burimeve të sigurisë rrugore. Përkufizimi i vlerësimit thekson se monitorimi dhe vlerësimi ndodhin brenda kornizave të sigurisë rrugore të cilat kanë ndryshime të konsiderueshme në dy dekadat e fundit. Përmbledhje e ndikimit të qasjes së Sistemit të Sigurt në monitorimin dhe vlerësimin.

- **Quiz: Klasifikimi i aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit**

#### **Moduli 2: Monitorimi & Vlerësimi në 2030**

Qasje në synimet e performancës globale të sigurisë rrugore të KB 2030, në të cilat GOA është nënshkruese dhe rishikimi i të dhënave të performancës 'fillestare' të paraqitura nga GOA në OBSH për Raportin e saj të Statusit Global për Sigurinë Rrugore 2018. Roli i drejtuesve në monitorimin sipas Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Rrugore. Rëndësia e monitorimit në nivelin e veprimeve, rezultateve të ndërmjetme dhe përfundimtare. Nevoja për të komunikuar dhe përdorur rezultatet në politikat, strategjitë, alokimin e burimeve dhe shpërndarjen e programit. Hyrje në ushtrimet 1 dhe 2.

## ***Dita 2: Treguesit e Performancës së Sigurisë***

### **Moduli 3: Indikatorët e Sigurisë Rrugore**

Përmbledhje e rolit të treguesve të performancës së sigurisë (SPI) në monitorim. Si përcaktohen SPI dhe nevoja thelbësore që ato të lidhen fuqimisht me fatalitetin dhe rrezikun serioz të lëndimit. Rëndësia e përkufizimeve shumë të qarta, të cilat janë rënë dakord dhe janë respektuar, për të siguruar që të gjitha të dhënat e mbledhura dhe të analizuar për SPI-të janë në përputhje të plotë me kalimin e kohës. Nevoja që SPI të jetë 'e realizueshme', domethënë ekziston udhëheqja institucionale dhe vullneti për të siguruar burime të disponueshme për të mbledhur, përpiluar dhe analizuar të dhëna në respekt të rreptë të SPI-ve me kalimin e kohës. Rëndësia e të dhënave fillestare. Rëndësia e përdorimit të rezultateve të të dhënave SPI për të komunikuar rezultatet dhe mbrojtjen e sigurisë rrugore për drejtuesit e vjetër në agjencitë qeveritare (përfshirë departamentet e financave që kontrollojnë financimin dhe buxhetet e qeverisë), për politikanët, për mediat dhe komunitetin.

Nevoja për të vendosur SPI në secilin nivel të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Rrugore. Kërkesat dhe standardet e KE për monitorimin e sigurisë rrugore. Përdorimi i të dhënave të trendit për të monitoruar në nivelet e ndërmjetme dhe përfundimtare të rezultateve. Përmbledhje e mënyrës se si krijohen SPI dhe përdorimi i tyre në nivelin e KE, në nivelet globale iRAP, EuroNCAP dhe në nivele kombëtare si në Australi.



- **Ushtrimi 1: Përlllogaritja e Kostove Social Ekonomike të aksidenteve në Shqipëri**
- **Ushtrimi 2: Interpretimi i të dhënave të raportit të sigurisë rrugore**
- **Ushtrimi 3: Identifikimi i objektivave të ndërmjetme në Shqipëri për vitin 2030**

## ***Dita 3: Vlerësimi i Sigurisë Rrugore***


### **Moduli 4: Hyrje në Vlerësimin e Sigurisë Rrugore**

Hyrje në vlerësimin e sigurisë rrugore dhe si ndryshon nga monitorimi. Termat, parimet dhe çështjet kryesore për hartimin dhe zbatimin e vlerësimit. Gjashtë hapat në procesin e vlerësimit, përcaktimi i objektivave të vlerësimit SMART, formimi, procesi, fazat e programit të vlerësimit të ndikimit dhe rezultateve dhe dizajne të zakonshme të hulumtimit të sigurisë rrugore - 'para dhe pas' (gjithashtu quhet 'para dhe pas') vlerësimi, 'çështja dhe kontrolli' dhe vlerësimet e serive kohore. U identifikuan dhe diskutuan arsyet tipike për dështimin e programeve në demonstrimin e rezultateve.

- **Ushtrimi 4 : Vlerësimi i trajtimeve që kanë synim parandalimin e aksidenteve kur mjeti del jashtë rruge.**
- **Rast Studimi – Vlerësimi i programit të limitit të shpejtësisë 40km/orë në Australi**
- **Vlerësimi Seminarit**



### SPIs Must Measure Each Level of the System



### WHO High Risk Behaviours to Monitor



### iRAP Risk Based Star Ratings for Roads






Figura 7– Përmbajtja e Seminarit

### The Global 21<sup>st</sup> Century Road Safety Framework



### Actions, Intermediate Outcomes and Final Outcomes or Impact



### Sample Safety Performance Indicators – OUTCOMES

Category	Examples of possible measures
Risk exposure	<ul style="list-style-type: none"> <li>Traffic volumes by vehicle and road user type</li> </ul>
Final safety outcomes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Deaths recorded by Police</li> <li>Hospital data for road deaths and injuries</li> <li>Other sources of death and injury registration</li> </ul>
Intermediate Outcomes	<ul style="list-style-type: none"> <li>Average vehicle speeds by road type, summer and winter</li> <li>Front and back seat safety belt wearing rates, driver and passengers</li> <li>Motor cycle helmet wearing rates - driver and pillion</li> <li>Drug impairment levels</li> <li>Skid resistance of road surfaces</li> <li>Road infrastructure crash safety ratings (risk and protection scores)</li> <li>Vehicle compliance with testing standards</li> <li>Vehicle crash safety ratings</li> <li>Average emergency medical services response times</li> <li>Targeted audience groups' recall and assessed relevance of publicity and awareness campaign messages</li> <li>Community attitudes to road safety</li> </ul>

Consultant Service for Road Safety Technical Assistance

### European Commission Draft SPIs for 2030 Targets

Indicator	Definition
Infrastructure	% of distance driven over roads with a safety rating above an agreed threshold
Speed	% of vehicles traveling within the speed limit
Vehicle safety	% of new passenger cars with a EuroNCAP safety rating above an agreed threshold
Safety belt	% of vehicle occupants using the safety belt or child restraint system correctly

### Summary of Key Issues in Setting National SPIs

- SPIs should monitor progress towards 2030 global targets.
- SPIs should be consistent with European Commission SPIs.
- The WHO high risk behaviours should be the priority for monitoring in the Safe Road User Pillar.
- If there is no SPI to monitor there will no focus on results.
- SPI definition must be clear to ensure consistent data is collected.
- If DEFINITIONS cannot be agreed AND/OR data cannot be collected **identify alternative SPIs.**

## 3. Vlerësimi i Seminarit lidhur me Monitorimin dhe Vlerësimin

### 3.1 Dita 1: Seminari Moduli 1 dhe 2

Një total prej 33 pjesëmarrësish përfunduan Modulet 1 dhe 2 të Seminarit. Pjesëmarrësit që morën pjesë janë përfaqësues nga MII, Bashkitë, Policia e Trafikut, Ministri të tjera / palët e interesuara siç ishte planifikuar dhe rënë dakord midis Klientit, Komitetit Drejtues dhe Konsulentit. Përfaqësues nga agjensitë kombëtare të rrugëve si dhe ato rajonale morën pjesë në trajnim.

Trajnimi u hap nga Specialisti i Menaxhimit të Sigurisë Rrugore dhe Drejtuesi i Ekipit të Projektit, me Menaxherin e Projektit, Eptisa dhe Specialistin e Analizës së Sigurisë NK-1 gjithashtu të pranishëm. Drejtuesi i Ekipit ftoi pjesëmarrësit të dërgojnë pyetje dhe komente mbi trajnimin përmes postës elektronike ose nëpërmjet chat-it.

Modulet 1 dhe 2 u dorëzuan nga Specialisti i Monitorimit dhe Vlerësimit KE-3.

### 3.2 Dita 2: Seminari Moduli 3

Një total prej 30 pjesëmarrësish përfunduan Ditën 2 të Seminarit për Ngritjen e Kapaciteteve të Monitorimit & Vlerësimit e cila u përqëndrua në përdorimin praktikave më të mira të monitorimit që duhen ndjekur për matjen e progresit drejt objektivave globale 2030.

Për shkak të gjëndjes jot ë mire shëndetësore të Ekspertit KE-3, ky modul u prezantua nga Specialisti i Analizës së Sigurisë NK-1

### 3.3 Dita 3: Seminari Moduli 4

Gjithsej 25 pjesëmarrës përfunduan Ditën 3 të Seminarit për Rritjen e Kapaciteteve Monitorimit & Vlerësimit e cila u përqëndrua në temën e Vlerësimit. Sesioni filloi me një rishikim të koncepteve dhe mësimëve kryesore të marra në Modulin 2. Sesioni zgjati 2.5 orë - megjithatë pjesëmarrësit mbetën të lidhur në internet deri në përfundimin e sesionit.

Moduli 3 u mbajt nga Specialisti i Monitorimit dhe Vlerësimit KE-3.

### 3.4 Përfundimi i Seminarit

Seminari përfundoi me një prezantim përfundimtar për të shqyrtuar dhe reflektuar mbi arritjen e objektivave të seminarit. Më pas pjesëmarrësit u falënderuan për pjesëmarrjen e tyre dhe u kërkua të plotësojnë Formularin Online të Vlerësimit të Pjesëmarrësve në Trajnim (shih Shtojcën 1).




Figura 8—Përmbledhja e Seminarit

### 3.5 Vlerësimi Seminarit

Konsulenti krijoi një formular online të vlerësimit të Seminarit i cili u plotësua nga pjesëmarrësit në fund të çdo sesioni trajnimi. Pjesëmarrësit u informuan se përgjigjet e vlerësimit ishin anonime dhe konfidenciale.

Mbi 90% e pjesëmarrësve përfunduan vlerësimin e Komponentit 1 i cili vlerësoi kënaqësinë e pjesëmarrësve lidhur me seancat e trajnimit, perceptimet e tyre mbi dobinë e trajnimeve, rëndësinë e secilës temë të trajtuar nga seancat e trajnimit dhe cilësinë e aspekteve organizative. Vlerësimi online u mendua krijua të ishte i shkurtër dhe shumë i lehtë për t'u kompletuar me përgjigje të vlerësuara në një shkallë 1-10. Rezultati i vlerësuar me 5 u klasifikua si "shumë i mirë" dhe një rezultat nën 5 i klasifikuar si "më pak se mesatarja".

Përgjigjet e vlerësimit Seminarit të Monitorimit dhe Vlerësimit tregojnë se pjesëmarrësit konsideruan që materiali i seminarit ishte shumë i rëndësishëm për punën e tyre dhe njohuritë dhe aftësitë e fituara nga seminari ishin shumë të dobishme në punën e tyre të përditshme.

- 69% e pjesëmarrësve e konsideruan përmbajtjen e seminarit shumë të rëndësishme (duke zgjedhur 5, në shkallën nga 1 në 5).
- Pjesa tjetër prej 31% e konsideroi seminarin të rëndësishëm.
- Asnjë pjesëmarrës nuk e konsideroi seminarin si të parëndësishëm.




Figura 9 – Rendesia e Seminarit M&E

Pavarësisht nga sfidat e trajnimit të paraqitura nga pandemia, organizimi i këtyre seancave trajnuese përmbushi pritshmëritë e pjesëmarrësve. Aspektet në lidhje me organizimin e seancave të trajnimit të vlerësuara nga pjesëmarrësit, përmbajtja e seancave të trajnimit, organizimi, kohëzgjatja e seancave të trajnimit dhe përkthimi u vlerësuan me 4.7 (shumë mirë) mesatarisht, në një shkallë nga 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë mirë). Për shkallën 1-5, një rezultat mesatar prej më pak se 3 është klasifikuar si 'më pak se mesatarja'.

Rezultatet e vlerësimit tregojnë që Seminari është përgatitur dhe realizuar mirë nga pikëpamja profesionale

- 77% e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar përkthimin gjatë séancës së trajnimit me 5 ( shkalla nga 1 në 5) ose **shumë mirë**.
- 73% e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar përmbajtjen e séancës së trajnimit me 5 ( shkalla nga 1 në 5) ose **shumë mirë**.
- 62% e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar gjatësinë e séancës së trajnimit me 5 ( shkalla nga 1 ne 5) ose **shumë mirë** .

Translation



Duration



Organization

Content

*Figura 10 –Vlerësimi me pikë i seminarit*

## ANEKSI A FORMULARI I VLERËSIMIT ONLINE

PROJECT IMPLEMENTED BY IV NTU/EP4SA  
FINANCED BY GDA AND COFINANCED BY WB

### Training sessions feedback form

\* Required

How satisfied are you with the trainings conducted within the project? \*

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

Not at all satisfied ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Very happy

How important are each of the following trainings for you, taking into account all aspects of the training such as content, coach, duration, etc.? (one answer per line) 1 Not at all important 5 Very important \*

	Not at all important	Not important	Neither important nor insignificant	The important ones	Very important
Road Safety Administration; Legislation; Funds and their distribution	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Analysis of data from road collisions 1, 2, 3	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Road Safety Engineering 1, 2, 3	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Road Safety Monitoring and Evaluation 1, 2, 3	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Conduct research to identify high-risk road users; Evaluating the effectiveness of a communication campaign; Best practices from other countries	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

How do you evaluate each of the training aspects? (one answer per line) 1 Very poor 5 Very good \*

	Very weak	Weak	Neither weak nor good	Good	Very good
Translation	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Organization	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Duration	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
content	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

In your opinion, how useful will these trainings be in your daily work? \*

1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

Not at all useful ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ Very useful

**Submission**